

1 E enjte, 18 korrik 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar i
6 seancë, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo
8 është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër
9 Hashim Thaçit, Rexhep Selimit, Kadri Veselit dhe Jakup
10 Krasniqit. Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

11 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
12 procesverbal të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në
13 sallën e gjyqit sot.

14 Përpara sesa të vijojmë me dëshminë e Dëshmitarit të
15 Prokurorisë 04752, ka disa çështje paraprake që dua të
16 trajtoj.

17 Së pari, Mbrojtja e Selimit kërkoi dje zgjatje të kohës
18 për t'iu përgjigjur parashtrimit të protokolluar F02451, që
19 është njoftimi i ZPS-së për dëshmitarët nga 19 gushti deri më
20 7 nëntor 20204. Mbrojtja e Selimit kërkoi një zgjatje afati
21 deri më 26 korrik sa i takon dëshmitarëve që janë planifikuar
22 që të dëshmojnë në bllokun e parë pas pushimit të Gjykatës dhe
23 deri më 23 gusht sa i takon dëshmitarëve të cilët nuk do të
24 japin dëshmi menjëherë pas pushimit të Gjykatës.

25 Duke pasur parasysh kërkesën dhe duke pasur parasysh

1 gjithashtu edhe pushimin e Gjykatës, Trupi Gjykues mendon që
2 ekziston shkak i arsyeshëm për sa i takon zgjatjes së afatit.
3 Për pasojë Trupi Gjykues miraton në pajtim me rregullën 9(5)
4 kërkesën e Mbrojtjes për të zgjatur kohën për t'u përgjigjur
5 për parashtrimin e protokolluar F02451 deri të martën, 29
6 korrik, lidhur me dëshmitarin të cilët janë planifikuar që të
7 dëshmi në bllokun e parë pas pushimit të Gjykatës, që është 9
8 gusht deri me 9 shtator. Dhe së dyti, të dorëzojë përgjigjen
9 deri me 23 gusht 2024 sa i takon dëshmitarëve të planifikuar
10 që do të dëshmojnë pas 5 shtatorit.

11 Ky është fundi i urdhrit të parë me gojë.

12 Së dyti, Trupi Gjykues dëshirojn që të sqarojë një
13 çështje me ZPS-në, përkatësisht dëshmitarët që do të vijnë në
14 bllokun e ardhshëm, pra nga 9 gushti deri me 5 shtator.

15 Me 10 korrik 2024 ZPS-ja dërgoi një listë tentative të
16 dëshmitarëve sa i takon këtij blloku seancash.

17 Me 16 korrik 2024, ZPS-ja dorëzoi parashtrimin F02451 dhe
18 njoftimin e Prokurorisë sa i takon dëshmitarëve nga 19 gushti
19 deri me 7 nëntor 2024. Trupi Gjykues e kupton që lista më e
20 vonë e tejkalon ose e zëvendëson listën e mëhershme.

21 Megjithatë, Trupi Gjykues dëshiron që të konfirmojë me ZPS-në
22 që të shtyjë planifikimin e dëshmitarëve të parë në shtojcën
23 1, që jepet në parashtrimin F2451 për bllokun e parë të
24 seancave pas pushimit gjyqësor.

25 Znj. Prokurore, nuk është e nevojshme që të jepni

1 përgjigje tani, por thjesht vlerësojeni këtë kërkesë dhe na
2 jepni përgjigje më pas.

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të jap përgjigje tani.
4 Ndryshimet në parashtrimin e fundit janë ato të duhura.
5 Domethënë, ajo është lista që neve synojmë të thërrasim në
6 bllokun e parë pas pushimit të Gjykatës.

7 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
8 tani do të vazhdojmë që të dëgjojmë dëshminë e Dëshmitarit të
9 Prokurorisë 04752.

10 Znj. Asistente, ju lutem, sillni në sallë dëshmitarin.

11 [Dëshmitari vijon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë se
13 erdhët, z. Zyrap. Shpresoj që ta keni kaluar mirë pasditen
14 mbrëmë.

15 DËSHMITARI: Po, faleminderit.

16 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kujtoj që
17 të përpiqni që t'i jepni përgjigje pyetjeve me fjali të
18 shkurtra dhe të qarta. Nëse nuk e kuptoni pyetjen lirisht mund
19 t'i kërkoni avokatit ta përsërisë pyetjen ose ta sqarojë
20 pyetjen në qoftë se nuk e kuptoni atë. Po ashtu ju lutem na
21 thoni se cila është baza e njohurive, rrethanave dhe fakteve
22 për të cilat do të pyeteni.

23 Flisni pranë mikrofonit, bëni një pauzë prej pesë
24 sekondash përpara sesa t'i përgjigje pyetjeve, dhe ju lutem
25 flisni ngadalë në mënyrë të tillë që t'ju kapin përkthyesit.

1 Nëse është e nevojshme që të bëni pushime, na e thoni
2 këtë gjë, dhe ne do të bëjmë organizimet e nevojshme. Ju
3 kujtoj që jeni ende nën detyrim që të thoni të vërtetën siç
4 keni deklaruar në betimin solemn.

5 Ju kujtoj gjithashtu sikurse ju kemi thënë javën e shkuar
6 dhe përpara asaj jave, që nuk ju kërkohet të përgjigjeni
7 pyetjeve të cilat janë vetëinkriminuese, në kundërshtim të
8 rasteve kur Trupi Gjykesues ju detyron ta bëni këtë gjë. Në
9 qoftë se ju bëhet një pyetje e kësaj natyre, avokati juaj mund
10 ta sjellë këtë në vëmendjen tonë dhe ne pastaj do të vendosim
11 në qoftë se ju duhet t'i përgjigjeni dhe në çfarë rrethanash
12 duhet t'i përgjigjeni pyetjes apo jo.

13 Do të vazhdojmë tani me pyetje plotësuese të Mbrojtjes së
14 Krasniqit.

15 Znj. Alagendra, e keni ju fjalën.

16 DËSHMITARI: Bislime Zyrapi [Vijon]

17 Pyetje vijuese të palës tjetër nga znj.

18 Alagendra: [Vazhdim]

19 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

20 PY. Mirëmëngjes, z. Zyrapi.

21 PË. Mirëmëngjesi.

22 PY. Kur përfunduar dhe po diskutonim rolet e Sokol Bashotës
23 dhe Jakup Krasniqit.

24 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të
25 paraqesë në ekran provën P847.

1 PY. Ndërkohë që paraqitet dokumenti në ekran, dje, në faqen
2 32 të transkriptit Gjykatësi Mettraux ju bëri një pyetje
3 lidhur me z. Bashota dhe z. Krasniqi, dhe ju thatë që ata të
4 dy nuk është se janë emëruar në të njëjtën kohë. Jo, ju kërkoj
5 ndjesë, përgjigja juaq ishte që:

6 "... ata të dy nuk janë emëruar në të njëjtën kohë, se z.
7 Krasniqi së pari ishte emëruar si zëvendëskomandant, dhe z.
8 Bashota është emëruar si zëvendës më vonë."

9 A ju kujtohet ta keni thënë këtë dje sa i takon kohës se
10 kur janë emëruar zëvendëskomandantët? A ju kujtohet që janë
11 bërë pyetje dje lidhur me këtë dje z. Zyrapi?

12 PË. Po.

13 PY. A e shihini, a ju kujtohet që e keni parë këtë
14 intervistë?

15 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do kërkoja që të kalonim tek
16 faqja 3001.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, u lexua
18 pyetja e Gjykatësit, po jo përgjigja.

19 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ja bëra pyetjen. E pyeta
20 dëshmitarin në qoftë se ju kujtohet që ju janë bërë pyetje sa
21 i takon kohës së emërimit të zëvendëskomandantit dhe ai u
22 përgjigj.

23 Tani le të kalojmë te faqja tretë e versionit në PDF që
24 kemi përpara.

25 PY. Do ju lexoj ato çfarë ka thënë z. Sylja:

1 "Pas ngjarjeve të 1997-s, ne u detyruam që të ndanim
2 detyrat. Zëvendësi im, Sokol Bashota, u vendos Shtabin e
3 Përgjithshëm dhe ka kryer pjesën më të madhe të detyrave në
4 periudhën midis dy takimeve në Rambuje."

5 Ajo çfarë thotë z. Syla këtu është që Sokol Bashota është
6 vendosur si shef i Shtabit të Përgjithshëm dhe si zëvendësi i
7 tij nga viti 1997. A është e saktë kjo, Dëshmitar?
8 PË. Unë nuk kam njohuri në ato që ka qenë prej 1997-s
9 zëvendëskomandant. Dhe me strukturë s'ka pas strukturë në atë
10 kohë për të qenë zëvendëskomandant. Edhe nuk mund ta spjegoj
11 diçka ç'ka nuk e di.

12 PY. Në rregull. Megjithatë po a pajtoheni me mua që këto janë
13 fjalët e z. Syla, siç duket në këtë intervistë kjo është ajo
14 çfarë ka thënë z. Syla, apo jo?

15 PË. Kjo është intervistë, po realiteti ka qenë ndryshe.

16 PY. Më 1 korrik 2024 keni dëshmuar, por keni deklaruar
17 gjithashtu edhe më herët në deklaratën e vitit 2019,
18 konkretisht në Pjesën 2, faqen 3, që kur keni mbërritur në
19 Kosovë në 1998 në maj të këtij viti, ju e keni kuptuar që
20 Sokol Bashota ishte drejtori i drejtorisë operative dhe ai ju
21 ka dhënë juve udhëzime. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

22 PË. Po, saktë.

23 PY. Në faqen 15 të transkriptit provizor dje, ju thatë që
24 Sokol Bashota ishte personi që ka komunikuar emërimin tuaj si
25 shef i drejtorisë operative në mes të korrikut 1998. A është e

1 saktë kjo, Dëshmitar?

2 PË. Po.

3 PY. Pra, nuk është e saktë sipas dëshmisë tuaj që Jakup
4 Krasniqi është caktuar si zëvendëskomandant si Sokol Bashota,
5 sepse sipas asaj çfarë shikojmë nga dokumentet që kemi përpara
6 Sokol Bashota ka qenë zëvendëskomandant që prej fillimit. A
7 është e saktë kjo, Dëshmitar?

8 PË. Znj. Avokate, unë e kam spjegu shumë mirë kur është
9 vendosun Jakup Krasniqi si zëvendëskomandant. Në këtë periudhë
10 unë kur kam mbërrit, nga qershori e deri në nëntor ka qenë
11 zëdhënës. Kurse, nëntor është vendos si zëvendëskomandant në
12 ristrukturim. Këtë e kam spjegu shumë mirë unë. Nuk di tjetër.

13 Në qoftë se ka pas një detyrë tjetër, unë nuk e kam dit.

14 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të paraqitet në ekran
15 dokumenti 1D006 [Sipas përkthimit].

16 PY. Ndërkohë që ky dokument paraqitet në ekran, z. Zyrapi, a
17 ju kujtohet që dje ju janë bërë pyetje nga Gjykatësi Gaynor
18 lidhur me marrëveshjen në Tiranë me 23 tetor 1998. Ju kujtohet
19 kjo?

20 PË. Po.

21 PY. A pajtoheni me mua se Jakup Krasniqi nuk ka qenë në
22 takimet as në Stamboll as në Tiranë? A është e saktë kjo?

23 PY. Po, e saktë.

24 PY. E keni konfirmuar gjithashtu që ju nuk keni qenë në
25 kontakt me Jakup Krasniqin gjatë këtyre bisedimeve. A është e

1 saktë kjo?

2 PË. Po, e saktë.

3 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem na paraqisni faqen 4
4 të këtij dokumenti.

5 PY. Nga ky dokument mund të shohim që personat e propozuar si
6 zëvendëskomandantë sipas kësaj strukture janë Sokol Bashota
7 dhe Ismet Alia, jo Jakup Krasniqi. A është e saktë kjo?

8 PË. Kjo është e saktë dhe e kam spjegu pse është kjo kështu
9 edhe si ka ndodh.

10 PY. Dje thatë, dhe kjo është dhënë në faqen 130 të
11 transkriptit provizor që:

12 "Autoriteti i tyre ka qenë atje që prej fillimit, që prej
13 krijimit të strukturës së parë të Ushtrisë Çlirimtare të
14 Kosovës."

15 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

16 PË. Po, e kam thënë.

17 PY. Ajo çfarë tregohet prej kësaj marrëveshjeje është që
18 Sokol Bashota ka qenë që prej fillimi kandidatura kryesore e
19 UÇK-së si zëvendëskomandanti kryesor ose i pari. A është e
20 saktë kjo, Dëshmitar?

21 PË. Po, e saktë.

22 PY. Qëndrimi ynë është, z. Zyrapi, që Sokol Bashota nuk ka
23 qenë vartës i Jakup Krasniqit. Kjo është e vërtetë, apo jo,
24 nuk ka qenë nën vartësinë e Jakup Krasniqit?

25 PË. Është e kjartë që s'ka qenë me rregullat ushtare, ose

1 qysh të dush ta marrim, komandant ato që e le të zëvendëson,
2 ai është mbi të gjithë.

3 PY. Në rregull. Z. Zyrapi, keni dhënë dëshmi disa herë në
4 gjykata të ndryshme, për shembull, përpara TPNJ-së, në
5 gjykatat e EULEX-it, e të tjerë. A pajtoheni me mua se ju nuk
6 keni thënë asnjëherë që Jakup Krasniqi ka qenë
7 zëvendëskomandanti i parë ose që Sokol Bashota ka qenë nën
8 vartësinë e Jakup Krasniqit? A pajtoheni me mua që nuk e keni
9 thënë asnjëherë një gjë të tillë në dëshmitë e mëhershme të
10 thëna, Dëshmitar?

11 PË. Është e sigurt që e kam thënë qysh kam deklaruar dhe tash
12 kur kam deklaruar kur është bërë pyetja, domethënë, cili ka
13 qenë ai që e përcakton komandanti, e len te zëvendëson, ai
14 është mbi të gjitha. Domethënë është mbi -- më i lartë epror
15 në atë kohë, në atë moment. E kështu që kjo është konteksti i
16 saj, i pari apo i dyti.

17 PY. Jo, po ajo për çfarë po të pyes është që kjo është hera e
18 parë që po e thua këtë gjë përpara kësaj Gjykate. A është e
19 saktë kjo, që s'e ka thënë ndonjëherë më herët këtë gjë?

20 PË. Po, e saktë është.

21 PY. Në faqen 18323 të transkriptit të datës 16 korrik,
22 Gjykatësi Barthe ju bëri pyetje se për kë zëvendëskomandant në
23 Kosovë e kishit fjalën kur thatë që drejtoria informative, G2-
24 shi, i raportonte në -- i raportonte një komandanti në Kosovë.
25 A ju kujtohet pikësepari t'ju jetë bërë kjo pyetje, Dëshmitar?

1 PË. Po.

2 PY. Dëshmia juaj ishte që drejtorja informative i raportonte
3 Jakup Krasniqit. A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

4 PË. Po. Pyetja ka qenë ndryshe, pyetja e bënun "Qysh ka shku
5 raporti". Një pjesë ka raportu te unë, një pjesë te
6 komandanti. Kjo, në këtë kontekst ka qenë pyetja edhe unë e
7 kam dhënë përgjigjen "po". Disa është raportu te unë, tjetër
8 është raportu te komandanti brenda, faktikisht,
9 zëvendëskomandanti i cili është përcaktu në detyrë në atë
10 kohë.

11 PY. Në rregull.

12 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i lutesha Sekretarit të
13 paraqesë në ekran provën P1356, më konkretisht faqen 6219.
14 Faqen 6219.

15 PY. Në çështjen Sainovic në vitin 2016, ju ka bërë pyetje
16 gjykatësi se:

17 "Kujt i ka raportuar, si është bërë raportimi i
18 drejtorisë informative dhe si është bërë ky raportim? Iu është
19 bërë raportimi juve si shef i shtabit, apo është bërë veçmas
20 pa njohurinë tuaj?"

21 Përgjigja që keni dhënë është kjo që:

22 "Gjatë janarit, shkurtit dhe marsit janë bërë raporte,
23 përfshirë këtu edhe raportet për komandantin e Shtabit të
24 Përgjithshëm."

25 Vazhdoni më tej dhe thoni që disa prej këtyre raporteve

1 kalonin përmes jush, por jo të gjitha kalonin përmes jush. A
2 ju kujtohet të keni dhënë këtë dëshmi, Dëshmitar?

3 PË. Po, saktë.

4 PY. Në 2006 kur ju kanë pyetur konkretisht se si është bërë
5 raportimi, a pajtoheni me mua që ju nuk i keni përmendur fare
6 zëvendëskomandantët në atë kohë, Dëshmitar? A është e saktë
7 kjo?

8 PË. Mund të jetë që s'e kam përmend. Po e kam përcaktu se ku
9 shkojnë raportet.

10 PY. Vazhdojmë më tej me dëshminë tuaj, me intervistën që i
11 keni dhënë Prokurorisë në vitin 2019, në faqen 10, faqja -- në
12 Pjesën 10, ju thoni:

13 "Duhet të kisha marrë informacion nga Kadri Veseli,
14 drejtoria informative dhe sektori juridik. Në përgjithësi ata
15 informonin komandantin e përgjithshëm, por edhe unë duhet të
16 informohesha gjithashtu."

17 Edhe në këtë rast, z. Zyrapi, ju thoni që edhe ju duhet
18 të ishit të informuar, çfarë do të thotë që drejtoria
19 informative dhe sektori juridik duhet t'ju informonin ju, ose
20 duhet t'i raportonit drejtpërsëdrejtë komandantit të
21 përgjithshëm. Këtë i keni thënë ZPS-së në 2019. A është e
22 saktë kjo, Dëshmitar?

23 PË. Po, edhe e kam shpjeguar pse është, sikur edhe tash. Mua mu
24 desh të raporton për aspektet ushtarake, lëvizjet e forcave të
25 armikut ku janë, tek janë, të gjitha, pra mujt me i shty [E

1 pakuptueshme] në atë pjesën e planeve operative.

2 PY. Në 2019 nuk keni përmendur fare Jakup Krasniqin apo
3 zëvendëskomandantët. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

4 PË. Po, e saktë. Është pyetur në cilën mënyrë e ku mund të --
5 ku duhet të raporton, për shembull, një drejtori e tillë. Edhe
6 e kam spjegu se ku shkon në mënyrën ushtarake.

7 PY. Z. Zyrapi, herën e parë që përmendni drejtorinë
8 informative që i raportonte Jakup Krasniqit ka qenë herën e
9 parë, pra, që e keni bërë këtë gjë që keni raportuar për këtë
10 linjë raportimi, ka qenë në qershor 2024 gjatë seancë
11 përgatitore. A është e saktë kjo, z. Zyrapi?

12 PË. Jo, nuk është veç tash në seancë përgatitore po është
13 edhe seanca dhe të tjera ku jam pyetur, për shembull, kur e
14 ditur që z. Azem Syla nuk ka qenë tanë kohën në Kosovë që ka
15 qenë jashtë, atëherë është [e pakuptueshme] që ka qenë
16 zëvendësit. Zëvendësi më shumë që ka qenë e ka lënë komandanti
17 ta zëvendëson, ka qenë z. Jakup Krasniqi, dhe atij i është
18 raportuar, si unë e të tjerë.

19 PY. Ajo çfarë po them unë është që, herën e parë kur e keni
20 thënë këtë gjë ka qenë në qershor 2024 dhe pastaj përpara
21 Gjykatës. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] U bë kjo pyetje dhe e mori
23 përgjigjen.

24 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

25 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

1 PY. Duke folur për përmbajtjen e raporteve informative, që ju
2 thoni keni marrë. Më 2 korrik 2024 jeni pyetur nga Prokuroria
3 në qoftë se komandantët kanë marrë të njëjtën informacione që
4 keni marrë edhe juve sa i takon informacioneve informative.

5 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Kjo është thënë në faqen 17345
6 të procesverbalit të Gjykatës.

7 PY. Sipas përgjigjes tuaj ju thoni kështu:

8 "Në atë kohë, me sa më kujtohet, të dyja palët kanë marrë
9 të njëjtin informacion."

10 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

11 PË. Po, kam thënë.

12 PY. Në çështjen Sainovic - në procesverbalin e Gjykatës është
13 prova P1356, faqja 6219 deri në 6220 - ju thoni sa më poshtë
14 në periudhën nga janari dhe marsi 1999:

15 "... raportet e drejtorisë informative kryesisht kanë
16 qenë lidhur me lëvizjet e forcave serbe, pozicionet e tyre dhe
17 gjendjen e tyre të gadishmërisë ..."

18 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

19 PË. Po, saktë.

20 PY. Këtë keni thënë edhe në seancën përgatitore me
21 Prokurorinë. A është e saktë kjo?

22 PË. Po, saktë.

23 PY. Pra, dëshmia juaj është që raportet informative përmbanin
24 kryesisht çështje operative dhe ushtarake. A është e saktë
25 kjo, Dëshmitar?

1 PË. Po, e saktë.

2 PY. Në Pjesën 10, faqja 10 e intervistës tuaj me ZPS-në, keni
3 thënë qartazi se nuk keni marrë asnjëherë asnjë raport që
4 është identifikuar ndonjë bashkëpunëtor brenda njësisë ose që
5 ishte arrestuar ndonjë bashkëpunëtor. Këtë keni thënë në 2019-
6 n. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

7 PË. Po, e saktë është.

8 PY. Përderisa e pamë që ju thatë që ju duhet të ishit personi
9 që duhet të kishit marrë raporte të tilla nga sektori juridik
10 dhe sektori informativ, ju thatë që nuk keni marrë raporte të
11 tilla, çfarë do të thotë që as komandanti nuk do të ketë pas
12 mundësi me marrë raporte të tilla. A është e saktë kjo?

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Spekulative.

14 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

15 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

16 PY. Më 9 korrik 20204, dëshmia juaj në përgjigje të pyetjeve
17 të z. Emmerson ishte që përpara mbërritjes së Mensur Kasumit,
18 që ka qenë diku nga fundi i janarit, fillimi i shkurtit, nuk
19 ka pasur asnjë zëvendës apo nuk ka pasur asnjë person që bënte
20 diçka sa i takon shërbimit informativ në nivel të Shtabit të
21 Përgjithshëm. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

22 PË. Po, e saktë është.

23 PY. Dje në faqen 49 deri në 50 të transkriptit provizor,
24 Gjykatësi Mettraux ju pyeti lidhur me Ferat Shalën. A ju
25 kujtohet kjo, Dëshmitar?

1 PË. Po, më kujtohet.

2 PY. Pyetja që iu bë ishte kjo:

3 "Ju u takuat me të sepse keni qenë në Shalë me Jakup
4 Krasniqin dhe Ramë Bujën."

5 Dhe ju thatë:

6 "Po, e saktë."

7 A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

8 PË. Po, më kujtohet dhe ashtu është.

9 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të
10 paraqesë në ekran dokumentin 077937-TR-ET Pjesa 7, faqja 10.

11 PY. Ndërkohë që ky dokument paraqitet në ekran, Gjykatësi
12 Mettraux më pas iu pyeti, "Në çfarë cilësie ishte Ferat Shala
13 aty?". Përgjigja që ju jepni, në faqen 50, rreshtat 2 deri në
14 4 [Sipas përkthimit] që kjo është një deklaratë e dhënë nga
15 Ferat Shala ku ai ka përshkruar këtë vizitë.

16 PË. Po, ashtu është.

17 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Kalojmë tek faqja 10 e
18 dokumentit në ekran.

19 PY. Përgjigja juaj ishte, pra domethënë, në përgjigje të
20 pyetjes të Gjykatësit Mettraux ju thoni:

21 "Po, ai ishte atje, por unë nuk e di se në çfarë cilësie
22 ishte ai atje, së bashku me një zëvendës."

23 Kështu keni thënë?

24 PË. Po, saktë. Ashtu bash kam thënë.

25 PY. Në faqen 10 të deklaratës së dhënë nga Ferat Shala,

1 përshkruhet vizita. Do lexoj për juve:

2 "Gjatë kësaj vizite, unë gjithashtu kam luajtur rolin e
3 shoferit. Kam pasur një automjet Jeep personal, kështu që e
4 kemi përdorur atë për të bërë pjesë të udhëtimit. Unë isha, në
5 qoftë se mund ta them, i riu, personi më i ri në moshë në atë
6 grup."

7 Pyetja që bëhet ishte kjo:

8 "Si ndodhi që ju e shoqëruar delegacionin dhe u bëtë
9 pjesë e tij?"

10 Përgjigje:

11 "Në atë kohë isha në Divjakë. Kisha shkuar atje disa
12 herë. E kuptova që z. Zyrapi dhe z. Krasniqi synonin që të
13 shkonin në Shalë dhe Llap përmes zonës së Drenicës. Ishte një
14 itinerar i gjatë i zonave rurale dhe duhej që të kaloje herë
15 pas here në vija fronti.

16 "Unë u vetëofrova, më pyeti z. Krasniqi dhe z. Zyrapi në
17 qoftë se mund t'i përcillja ata dhe unë pranova. Ishte një
18 rast i mirë për mua që të vizitoja zona të tilla operative, në
19 kushte të tilla lufte."

20 Këtë ka thënë z. Ferat Shala.

21 Pajtoheni me mua besoj, z. Zyrapi, që sipas Ferat Shalës
22 ju nuk e keni takuar atë në Shalë. Ai thotë, që kur ai e
23 kuptoi që ju dhe z. Krasniqi synonin që të shkonin në zonën --
24 në Shalë dhe Llap përmes zonës së Drenicës, ai u vetëofrua dhe
25 po ashtu i ka kërkuar ose e ka pyetur z. Krasniqi dhe juve që

1 të mund ta përcillnit. A është kështu? A është e saktë kjo,

2 Dëshmitar?

3 PË. Unë shumë mirë kur më kanë pyetur për këtë pyetje që kam

4 thënë për z. Ferat Shala, që Ferat Shala edhe ai ka qenë

5 bashkë me këtë grupin kur kemi shkue në Shalë. Jo në Shalë,

6 s'e kam taku në Shalë, kemi shku bashkë në Shalë. [E

7 pakuptueshme] unë e di çfarë kam fol.

8 PY. Faleminderit që na e sqaruat, Dëshmitar. Ju nuk e

9 diskutoni faktin që Ferat Shala iu ka përcjellë juve si shofer

10 në këtë udhëtim sepse ishte një rrugë e gjatë që kalonte nëpër

11 zona të shumta rurale. A është kështu, Dëshmitar?

12 PË. Po, e saktë është kjo.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Znj. Alagendra, po

14 sugjeroni ju që z. Shala ka qenë vozitës në këtë rast? Sepse

15 nëse po përpiqeni të thoni këtë, mbase duhet ta pyesni

16 dëshmitarin në mënyrë që ne të marrim përgjigje dhe shpjegim

17 se çfarë po bënte ai në këtë zonë në atë kohë. Apo po thoni ju

18 që në përgjithësi ai ishte një vozitës?

19 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Jo, dua të them që nuk janë

20 takuar atje dhe thjesht kanë udhëtuar së bashku. Dhe ai e

21 sqaroi, dëshmitari, tha që në këtë rast ka qenë vozitësi.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ai shpjegoi znj.

23 Alagendra dhe se çfarë ka bërë në ato zonë në atë kohë.

24 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Po, faleminderit.

25 PY. Z. Zyrapi në transkript, në faqen 1835 ju pyeti Gjykatësi

1 Barthe, kush e mbikëqyrte punën e sektorit juridik dhe të
2 Sokol Dobrunës. Më pas ju pyeti nëse dy zëvendëskomandantët
3 ishin përgjegjës për mbikëqyrjen e punës së sektorit juridik;
4 dhe nëse po, cili prej të dyve ishte përgjegjës për këtë.

5 A ju kujtohet kjo pyetje?

6 PË. Po.

7 PY. Ju u përgjigjët kështu:

8 "Që të dy, po kryesisht Jakup Krasniqi sepse ishte më
9 pranë atje."

10 Ju kujtohet?

11 PË. Po, saktë. Ashtu kam thënë.

12 PY. Dhe ju pajtoheni me mua, z. Zyrapi, se nuk keni parë
13 ndonjë udhëzim me shkrim nga Sokol -- nga -- më falni, Jakup
14 Krasniqi drejtuar Sokol Dobrunës për çështje që lidhshin me
15 sektorin juridik, kështu?

16 PË. Jo. Është e vërtetë, nuk kam pa asnjë shkresë.

17 PY. Gjithashtu as nuk keni parë ndonjë raport me shkrim
18 drejtuar nga Sokol Dobruna, Jakup Krasniqit për sektorin
19 juridik, kështu?

20 PË. Jo. S'kam mujt me pa raporte se nuk më ka dhënë mua
21 përgjegjësi ai. I ka dhënë [e pakuptueshme] përgjegjësi
22 komandës, jo mua. Edhe raporti ka shku drejt atje, nuk di
23 çfarë raporte, sa ka shkruar, ka shkruar. Është çështja krejt
24 tjetër, nuk është e imja.

25 PY. A pajtoheni me mua, z. Zyrapi, se shefi i sektorit

1 juridik, Sokol Dobruna, është personi i duhur për të thënë se
2 kush prej këtyre zëvendëskomandantëve e mbikëqyrte sektorin
3 juridik dhe kujt i raportonte ai, nëse ju raportonte atyre?
4 PË. Sikur që ai është kompetent, kallzon atë se kujt i ka
5 raportu dhe kush ka qenë përgjegjës.

6 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Shohim në ekran materialin
7 054739-TR-ET Pjesa 2, faqja 10.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do i lutesha avokates që
9 dokumente të tilla të mos i shfaqnim në ekran.

10 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Në rregull. Unë po e lexoj
11 atëhere.

12 PY. Z. Dobruna -- z. Dobruna i është bërë një pyetje:

13 "Do të doja t'ju pyesim edhe një herë se kujt i
14 raportoni. Besoj se në një nga dëshmitë tuaja keni thënë se i
15 raportoni Azem Sylës."

16 Ai u përgjigj kështu:

17 "Është e kuptueshme, është e kuptueshme. Ai ishte
18 komandanti."

19 E më tej vijon e thonë:

20 "Nuk më kujtohet se sa herë, se nuk kishim kohë që të
21 bënim raporte të rregullta për askënd."

22 Keni ndonjë arsye për ta kundërshtuar dëshminë e tij, z.
23 Zyrapi?

24 PË. Jo, aspak. Është dëshmia e tij.

25 PY. Më tej z. Dobruna thotë --

1 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Dhe për procesverbal është

2 Pjesa 9, faqja 9, rreshtat 40 dhe 9 të intervistës së tij.

3 Pra, ai thotë -- pyetet:

4 "Pra që ta konfirmojmë, ju nuk keni pasur ndonjë linjë
5 zyrtare raportimi me këta persona?"

6 Përkthyesi ka pyetur:

7 "Zyrtar apo jozyrtar?"

8 Është bërë korrigjimi.

9 "Zyrtar. Pra keni pasur komunikim zyrtar për të raportuar
10 mbi punën tuaj?"

11 Z. Dobruna, është përgjigjur:

12 "Jo. Nuk ka pasur kohë për t'i kryer këto gjëra."

13 Keni ndonjë arsye për ta kontestuar këtë, z. Zyrapi?

14 PË. Jo.

15 PY. Ju treguan provën P1105.

16 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Edhe ndërkohë do kërkoja që
17 kjo provë të shfaqej në ekran.

18 PY. Ua tregoi Gjykatësi Barthe gjatë pyetjeve të veta.

19 Ndërkohë që e presim këtë provë, mund t'ju them që Gjykatësi

20 pyeti nëse e keni parë personalisht z. Jakup Krasniqi, Rexhep

21 Selimi dhe Fatmir Limaj në komandë bashkë me Blerim Kuqin. Më

22 falni, do t'ua lexoj pyetjen:

23 "Z. Zyrapi, nga e dini ju që Jakup Krasniqi, Rexhep

24 Selimi dhe Fatmir Limaj kanë qenë në komandë me Blerim Kuqin?

25 A e pe me sytë e ty?"

1 Ju u përgjigjët:

2 "Kur thashë që kam qenë i pranishëm dhe unë në takim, pra
3 kur erdhën, pasi erdhën ata unë u largova bashkë me Drinin,
4 dhe ata qëndruan atje bashkë me Blerim Kuqin dhe në bazë të
5 kësaj po e them këtë."

6 Ju kujtohet kjo dëshmi, z. Zyrapi?

7 PË. Po, saktë.

8 PY. Pra, dëshmia juaj është që ju jeni larguar bashkë me
9 Drinin për të shkuar tek zyra ose tek ambienti ku qëndronte
10 drejtoria operative, kështu?

11 PË. Po, saktë.

12 PY. Ju e dini që Blerim Kuqi e njihte -- njihej me z.
13 Krasniqi që para këtij rasti?

14 PË. Po.

15 PY. E dinit që kishin një marrëdhënie të mirë dhe e
16 respektonin njëri-tjetrin?

17 PË. Kanë pas marrëdhëniet e mira.

18 PY. Pra, pajtoheni me mua që z. Krasniqi -- fakti që z.
19 Krasniqi ka biseduar me Blerim Kuqin nuk është asgjë e
20 pazakontë?

21 PË. Jo. Askush s'tha që është e pazakontë.

22 PY. Më pas ju pyetën "Kush e mori vendimin ta ndalonte Blerim
23 Kuqin, dhe po u lexoj çfarë keni thënë ju në faqen 18326. Ju
24 thatë:

25 "Pikësëpari, unë nuk e di saktësisht kush e lëshoi

1 vendimin. Di që është lëshuar një vendim për të ndaluar Blerim
2 Kuqin. Ata që kanë qenë të pranishëm e dinë më mirë se kush e
3 lëshoi këtë vendim. Unë fizikisht nuk kam qenë i pranishëm aty
4 kur është përpiluar ky vendim apo kur është lëshuar ky vendim.”

5 Kështu?

6 Që të jemi të qartë, z. Zyrapi, që të jemi të qartë, pra
7 ju në këtë Gjykatë keni thënë që nuk keni qenë i pranishëm
8 fizikisht kur është marrë vendimi për arrestimin e Blerim
9 Kuqit dhe se nuk e dini se kush e ka marrë këtë vendim. Saktë?

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E ka dhënë përgjigjen tre
11 herë, znj. Alagendra.

12 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Kjo është një pyetje që e kanë
13 trajtuar dhe Gjykatësit.

14 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
15 lëreni këtë pyetje sepse është bërë disa herë dhe e ka marrë
16 përgjigjen.

17 Na kujtohet dëshmia e tij.

18 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Në rregull. Atëherë po
19 vazhdoj.

20 Shohim në ekran materialin 4D28 -- 78, në faqen 053944.

21 PY. Presim provën. Por ndërkohë mund t'ju them se në prill
22 2011, z. Zyrapi, mbase ju kujtohet që jeni thirrur si
23 dëshmitar në një hetim? Ju kujtohet?

24 PË. Prill 2011?

25 PY. Po, prill 2011.

1 PË. Po.

2 PY. Deklarata që keni dhënë në prill 2011 është kështu:

3 "Pasi u kthye në dhjetor 1998, u mor vendimi për të
4 arrestuar Kuqin dhe për ta nxjerrë para gjykatës ushtarake që
5 të jepte llogari pse u larguar nga pozicioni i tij. Ai u
6 arrestua dhe Dobruna më kërkoi disa herë këshilla."

7 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Për Sekretarin, dokumenti
8 është gabim. Ishte 4D78. ERN-ja është 053941 deri në 053952.

9 PY. Z. Zyrapi ju kujtohet që ta keni thënë këtë në 2011-n?

10 PË. Shumë mirë më kujtohet që e kam thënë që ashtu ka qenë.

11 Këshilla z. Dobruna, jo vetëm për këtë rast, por më ka kërkua
12 çdo herë këshilla se si të vepron në aspektet ushtarake,
13 aspektet profesionale që i kam dhënë që shkon, cilat janë.

14 Edhe ato që i kam ofru mbështetjes ose dhe sigurisë. Këto kanë
15 qenë kontaktet me z. Dobruna.

16 PY. Në rregull. Në qershor 2013, keni qenë dëshmitar në
17 çështjen Kleçka, apo jo?

18 PË. Po, saktë.

19 PY. Dëshmia juaj ka qenë e tillë, pra, Blerim Kuqi u arrestua
20 nga sektori juridik dhe u mor pyetje. A ju kujtohet kjo
21 dëshmi?

22 PË. Me siguri.

23 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Për procesverbal kjo gjendet
24 në materialin 4D77.

25 PY. Në 2019, në intervistën për ZPS-në, Pjesa 6, faqja 27,

1 rreshtat 20 dhe 19, kur ju pyetën për rastin e Blerim Kuqit a
2 u diskutua kjo në ndonjë takim të Shtabit të Përgjithshëm, ju
3 jeni përgjigjur:

4 "Po."

5 Në faqen 28, keni thënë që:

6 "Z. Blerim Kuqi do të arrestohej dhe do të merrej sektori
7 juridik me të. Do të shqyrtonte arsyet pse ishte larguar dhe
8 do shqyrtonte dëmin që i kishte shkaktuar njësisë."

9 A ju kujtohet kjo në 2019?

10 PË. Po, saktë.

11 PY. Dhe në faqen 29, Pjesa 6, rreshtat 2 deri në 7 të
12 intervistës tuaj, trajtohet pika kujt i ka treguar Sokol
13 Dobruna për vendimin, ju jeni përgjigjur:

14 "Jakup Krasniqit, por të gjithë të pranishëm kemi qenë
15 atëherë."

16 Saktë?

17 PË. Po, saktë është.

18 PY. Pra, duke i parë të gjitha këto, z. Zyrapi, pajtoheni me
19 mua që në 2019 e keni pranuar që ju keni qenë i pranishëm kur
20 është diskutuar ky rast, saktë?

21 PË. [Folës që flasin njëkohësisht]

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kjo ishte një pyetje shumë e
23 përgjithshme dhe nuk pasqyron saktësisht atë që ka thënë
24 dëshmitari.

25 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

1 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

2 PY. Gjatë dëshmisë këtu në këtë Gjykatë, z. Zyrapi, jeni
3 përpjekur të distancoheni nga ky rast, dhe keni thënë që nuk
4 keni qenë i pranishëm fizikisht kur është marrë ky vendim. Kjo
5 është e qartë. Por ju keni thënë disa herë këtu dhe më parë që
6 Sokol Dobruna është konsultuar me ju për rastet me të cilat
7 merrej, përfshirë këtu rastin e Blerim Kuqin.

8 PË. Së pari di -- ndan këtu konsultime kjesh shumë i kjartë,
9 se ç'ka është konsultu me mu dhe për cilat konsultime, një. E
10 dyta, nuk i kam ik asaj që kemi qenë në takime, që është majt
11 takim [E pakuptueshme] ma herët dhe që është marrë ky vendim
12 që të merret Blerim Kuqi prej sektorit juridik, por marrjen e
13 vendimit të tillë për arrestimin e tij, nuk kam qenë. Kam qenë
14 para se kur ka ardhun, por jo kur është marrë. Kështu që ka
15 dallimet ato që po i bëni ju pyetjet dhe që po tentoni edhe të
16 shkoni.

17 PY. T'i kthehemi përgjigjes që i dhatë Gjykatësit Barthe, që
18 -- kur thatë që Jakup Krasniqi mbikëqyrte sektorin juridik. Në
19 vitin 2019, kur është diskutuar sërish çështja e Blerim Kuqit
20 ju keni thënë që jo vetëm që i keni dhënë këshilla Sokol
21 Dobruna po dhe i keni bërë rekomandime Sokol Dobrunës të
22 merrte informacione, të merrte dhe shënime, shënimet përkatëse
23 dhe të kishte prova në mënyrë të atillë që raste të tillë të
24 gjykoheshin në kohë paqeje. Ju kujtohet?

25 PË. Po, saktë, po thuhet "të merren shënime" informacione për

1 çdonjënin disa raste nuk mund t'i vepron gjykimet e tyre në
2 atë kohë, të mirren vetëm shënimet dhe pas luftës ato të qiten
3 te sektori juridik dhe të mirren masat adekuate, ose të mos
4 mirren.

5 PY. Pra, duke u mbështetur në vetë dëshminë tuaj, besoj se
6 pajtoheni me mua që Sokol Dobruna për këshilla dhe rekomandime
7 ju ka kontaktuar ju, dhe jo Jakup Krasniqin?

8 PË. Jo, ashtu. Këshillat i kam dhënë në aspektet profesionale
9 ushtarake, edhe i thashë cilat kanë qenë të miat edhe
10 këshillat. Kur të më thuhet përgjegjësitë nën kënd është, e
11 gjithi ka qenë përgjegjësinë e komandantit ose kabinetit të
12 komandantit të Shtabit të Përgjithshëm. Dhe në mungesë të
13 komandantit është zëvendësi, pa marrë parasysh cili është,
14 cilin e ka lënë komandanti, edhe ai i jep përgjegjësi atij. Të
15 jemi shumë të kuartë me aspektin e sistemit të komandimit edhe
16 të udhëheqjes, pa marrë parasysh edhe pse s'kemi qenë një
17 ushtri e rregull, po një farë rregulli ka pas.

18 PY. Në 2019 -- në 2019, Pjesa 6, faqja 31 e intervistës suaj
19 me ZPS-në, ju keni thënë se ju nuk e dini a është konsultuar
20 Dobruna me anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm, saktë?

21 PY. Saktë është. As më ka raportu me më kallxu mu, as me pa
22 unë a konsultohet a s'konsultohet me ta.

23 PY. Do t'ju lexoj atë që i ka thënë Sokol Dobruna hetuesve
24 kur e kanë pyetur se kush e kishte kompetencën për lirimin e
25 personave të ndaluar. Kjo është në materialin 054739. Ai

1 thotë:

2 "Ata që e dënonin. Kështu kemi vepruar dhe me Blerim
3 Kuqin. Ne e dënuam, ne e liruam."

4 E kontestoni këtë?

5 PË. Jo, s'kam çfarë e kontestoj. E drejta e atij ka qenë.

6 PY. Pajtoheni me mua se Sokol Dobruna si shef i sektorit
7 juridik dhe që është marrë me këtë rast, duhet ta dijë se kush
8 e ka pasur autoritetin apo kompetencën për lirim të Blerim
9 Kuqit?

10 PË. Po, saktë.

11 PY. Do t'ju them se çfarë ka qenë tjetër Sokol Dobruna për
12 lirim, kush e kishte kompetencën për lirim.

13 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Për procesverbal është
14 materiali 054739, Pjesa 8, faqja 13, rreshtat 15 deri në 18.

15 Hetuesi e pyet:

16 "Ka qenë autoriteti i Bislime Zyrapit? Ai e ka pasur
17 autoritetin për të urdhëruar lirimet?"

18 Z. Dobruna përgjigjet:

19 "Patjetër se duheshin respektuar radhët -- hierarkia,
20 duhej respektuar hierarkia."

21 E kontestoni këtë, z. Zyrapi?

22 PË. Lexoni dhe një herë.

23 PY. Pra, i është bërë pyetje, z. Dobruna:

24 "Pra, ka qenë kompetencë e Bislime Zyrapit? Ai e kishte
25 kompetencë të urdhëronte lirimet?"

1 Dhe z. Dobruna është përgjigjur kështu:

2 "Patjetër sepse duhej respektuar hierarkia."

3 PY. Hierarkia është diçka tjetër, tjetër send është mbikëqyr.

4 Unë nuk kam qenë mbikëqyrësi i tij, domethënë në këtë aspekt

5 që po e thoni, dhe nuk kam mujt me i thonë unë "Liroi" ose mos

6 "I liro" se a kon e drejta e atij edhe e komandës, jo e imja.

7 Unë kam mujt veç e propozu ose me e këshillu.

8 PY. Sokol Dobruna është konsultuar me ju për lirimin e të

9 ndaluarve kur filluan bombardimet e NATO-s, apo jo?

10 PË. Konsultimi është, po. Por tjetër send është konsultimi,

11 tjetër send është ç'ka thatë pak më herët.

12 PY. Përfshirë këtu edhe rastin e Blerim Kuqit edhe ju e

13 këshilluat Sokol Dobrunën që ta lironte, apo jo?

14 PË. Nuk është veç Blerim Kuqi, po gjithë çka kanë qenë ushtarë

15 në atë kohë që të lirohen dhe kthehen në njësi kah kanë ardhë,

16 domethënë nga janë pru, edhe pas luftës shifet pastaj të

17 merren masat, të shqyrtohen më tutje në aspekte juridike. Kjo

18 ka qenë këshilla ime që e kam dhënë.

19 PY. Në fakt, përfundimisht Blerim Kuqi u lirua, apo jo?

20 PY. Jo vetëm Blerim Kuqi por të gjithë. Se filluan

21 bombardimet edhe janë shpërndarë gjithë ushtarët, të gjithë,

22 edhe Blerim Kuqi, janë kthy në njësitë e veta dhe kanë vazhdu

23 pranë njësave të veta deri në përfundim të luftës.

24 PY. A e dini, z. Zyrapi, se Kurtesh Fondaj dha dëshmi para

25 kësaj Gjykate?

1 PË. E di që ka dhënë dëshmi, po.

2 PY. Do t'ju lexoj dëshminë e tij lidhur me rastin e Blerim

3 Kuqit. Ka qenë 25 qershor 2024, është në transkript faqja

4 17149 deri në 17150. E pyetën:

5 "A të kujtohet që keni folur me Bislime Zyrapi për rastin
6 e Blerim Kuqit?"

7 Ai u përgjigj:

8 "Po, e kam diskutuar me hollësi me Bislime Zyrapi, dhe i
9 thashë që duhet sqaruar rasti i Blerim Kuqit se ai nuk ka
10 dezertuar dhe ka pasur një gabim në interpretimin e rastit të
11 tij dhe arrestimit të tij, sepse në atë kohë Blerim Kuqi ishte
12 e qartë që e kishte ndihmuar UÇK-në."

13 Dhe e pyetën z. Fondaj, atëherë:

14 "Padyshim që ju menduat se duke qenë se Bislime Zyrapi
15 ishte shef shtabi ishte në pozicion që të bënte diçka lidhur
16 me këtë rast?"

17 Ai u përgjigj:

18 "Unë jam i bindur se deklarata e Bislime Zyrapi do të
19 ishte vendimtare për fatin e Blerim Kuqit dhe unë ia
20 komunikova Bislime Zyrapi dhe ja sqarova këtë detaj pse kishte
21 shkuar ai në Shqipëri."

22 Keni ndonjë arsye për ta kontestuar dëshminë e z. Fondaj?

23 PË. Është dëshmia e tij. Nuk mund ta kontestoj.

24 PY. Kemi parë dhe dëshmi të mëparshme të tuajat dhe kemi

25 folur për lirimin e pesë të moshuarve serbë, z. Zyrapi, dhe

1 lidhur me këtë rast ju keni pasur një bisedë me Sylejman
2 Selimin dhe i kërkuat atij që t'i lironte këta, apo jo?
3 PË. Gjë normale që ka qenë kërkesat të bëhet -- edhe unë si
4 shef shtabi e kam bërë kërkesën që t'i liron. Ajo është pastaj
5 e tijna a ka vepru a s'ka vepru [E pakuptueshme].

6 Se së pari, ai s'është dashtë të vepron hiç fare në ato
7 me urdhër që kemi dhënë na më herët, po kanë vepru siç kanë
8 vepru edhe kemi pas këto veprime.

9 PY. Gjykatësi Barthe ju foli dhe për rastin e Cen Deskut dhe
10 Jakup Kastratit. Kjo ka qenë në pjesën 37 [Sipas përkthimit]
11 të intervistës suaj me ZPS-në, Pjesa 3. Dhe thatë që kur keni
12 folur me anëtarët e UÇK-së për këtë rast, thatë që keni folur
13 me anëtarët e UÇK-së të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së për
14 këtë rast kur u bëtë shef shtabi. Ju kujtohet?

15 PË. Po.

16 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Për procesverbal kjo është
17 përmendur në transkript në faqen 18373.

18 PY. Dhe pas kësaj në vijim të këtij rasti ju keni lëshuar
19 urdhrin e 28 nëntorit 2000 -- 1998, saktë?

20 PY. Jo vetëm për këtë rast, por dhe ka qenë, domethënë,
21 ankesat, kam tregu që kanë qenë nga komandantat dhe nga vetë
22 zonat, në kontekst të kësaj e kam lëshuar. [E pakuptueshme]
23 Kjo edhe tash edhe kjo edhe ky rast ka ndodh, po nuk kam dit
24 qysh ka ndodh edhe s'kam qenë këtu. Kontekst ka edhe veprimet
25 e ndryshme të cilat në atë kohë kanë qenë negative për

1 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

2 PY. Në Pjesën 5, faqja 11, e intervistës suaj me ZPS-në në
3 2019, keni thënë se jeni konsultuar me komandantin dhe i keni
4 dhënë ju direktiva se si duhet të funksiononin gjërat në të
5 ardhmen dhe se si të vepronin në të ardhmen. A ju kujtohet
6 kjo?

7 PË. Po, saktë.

8 PY. Gjithashtu, thatë dje se komandantët e zonës, civilët
9 edhe ushtarët të drejtoheshin ty me ankesat që kishin.

10 PË. Nuk kishte veç ankesa drejt meje, të jemi të kjartë në
11 atë punë. Ankesat kanë kenë te anëtarë të tjerë të shtabit. Po
12 është përmbledhje e të gjithëve, domethënë që janë marrë
13 informacione nga komandantët, nga zonat, nga civilët, si unë,
14 si anëtarë të tjerë të shtabit dhe është përpilu ky dokument.

15 PY. Por pajtoheni me mua se iu drejtoheshin ju sepse ata
16 besonin se çështjet operative ishin pjesë e përgjegjësive
17 tuaj, apo jo?

18 PË. Sigurisht që pjesët operative kanë qenë të miat si
19 drejtori i operativës, si shef i shtabit -- çështjet operative
20 shefi i shtabit, drejtoria operative. Është aty pa diskutim.

21 PY. Në faqen 34, rreshti 14 i transkriptit të djeshëm,
22 Gjykatësi Mettraux ju pyeti nëse vendimet operative
23 lëshoheshin edhe nga anëtarë të tjerë të Shtabit të
24 Përgjithshëm që ishin në terren në Kosovë. Ju u përgjigjët:

25 "Në mungesë të komandantit i miraton apo i lejon

1 zëvendëskomandanti këto veprime apo operacione.”

2 A ju kujtohet?

3 PË. Po, saktë.

4 PY. Pajtoheni me mua, z. Zyrapi, se pasi keni ngritur ankesat

5 që keni marrë me Azem Sylën, Azem Sylja iu urdhëroi ju ta

6 dërgonit këtë udhëzim, ose më saktë ai ju udhëzoi ju të

7 lëshonit urdhrin e 28 nëntorit ku thuhej që të parandaloheshin

8 të gjitha rastet negative, ngjarjet negative, kështu?

9 PË. Po, saktë. Këtë e kam thënë edhe atëhere edhe tash e
10 them.

11 PY. Dhe Azem Sylja nuk i tha Jakup Krasniqit ta dërgonte

12 urdhrin e 28 nëntorit 1998, por ishit ju personi që u udhëzuat

13 për ta bërë këtë, apo jo?

14 PË. Po, saktë është.

15 PY. Pjesa 5, faqja 11 e intervistës suaj, keni thënë, “Kur

16 nuk ishte komandanti i pranishëm, ishit ju personi që lëshonit

17 urdhra për të gjithë komandantët e zonave”. Kjo është në

18 Pjesën 5, faqja 11, e intervistës suaj.

19 PË. Më fal, të cilës intervistë është kjo, dhe cilës datë?

20 PY. Është intervista që keni dhënë për ZPS-në në 2019. Ju

21 kërkoj ndjesë.

22 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

23 Alagendra, folët njëkohësisht, thojeni edhe një herë.

24 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Pjesa 5, faqja 11, e

25 intervistës suaj. Keni thënë:

1 "Isha unë, Rexhep Selimi, Lahi Brahimaj dhe Fatmir Limaj.
2 Janë diskutuar gjëra të ndryshe dhe iu thashë që nuk është
3 komandanti i pranishëm. Deklarova se isha konsultuar me
4 komandantin dhe dhashë udhëzime se si duhet të vepronin në të
5 ardhmen. Dhe duheshin -- duhet të njoftoheshin të gjithë
6 komandantët e zonave dhe njësive lidhur me këtë."

7 A e keni thënë këtë në 2019?

8 PË. Saktë. Këtë e kam thënë qysh e lexove, po.

9 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do bëjmë pushim në orën 10.00,
10 të nderuar Gjykatës? Do jetë me vend që ta bëjmë tani mbase?

11 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
12 pushim 10 minuta, Avokat.

13 Mund të dilni nga salla në shoqërinë e Asistentes.

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pas pushimit
16 do të keni vetëm 20 minuta në dispozicion derisa të përfundoni
17 me pyetjet. Edhe 20 minuta keni, jo më shumë se kaq.

18 ZNJ. ALAGENDRA: [Mikrofoni çaktivizuar].

19 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushimin
20 tani.

21 --- Seanca ndërpritet në orën 10.00

22 --- Seanca rifillon në orën 10.11

23 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

24 Asistente, silleni dëshmitarin në sallë.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Zyrapi,
2 tani do të vazhdojmë me pjesët e mbetura nga Mbrojtja e z.
3 Krasniqi.

4 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]
5 PY. Z. Zyrapi, ju pajtoheni me mua apo jo, që në përgjigje të
6 pyetjeve që ju kanë bërë Gjykatësit më 16 dhe 17 korrik, se ju
7 -- domethënë, unë do t'ju bëj disa sugjerime ose propozime dhe
8 duhet të më thoni në qoftë se pajtoheni apo jo. Ju keni thënë
9 që drejtoria informative i ka raportuar Jakup Krasniqit për
10 herë të parë. Keni thënë gjithashtu Jakup Krasniqi ka
11 mbikëqyrur sektorin juridik dhe keni thënë që Jakup Krasniqi e
12 ka pas kompetencën për urdhërimin e arrestimit të Blerim
13 Kuqit. Dhe për herë të parë keni thënë gjithashtu që një prej
14 tre personave në komandë ka qenë personi i cili ka urdhëruar
15 arrestimin e Blerim Kuqit.

16 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Këtë e keni thënë në faqen
17 18327 të transkriptit të datës 16 korrik.

18 A pajtoheni me mua që këto i keni thënë për herë të parë
19 këtu, Dëshmitar?

20 PË. Po, i kam thënë këtu.

21 PY. Në vitin 2019 kur jeni marrë në intervistë si i dyshuar,
22 në atë, ju nuk e keni ditur, apo jo, z. Zyrapi, në qoftë se do
23 të ngriheshin akuza ndaj jush?

24 PË. Jo.

25 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Kërkoj të paraqitet tani në

1 ekran dokumenti DJK00924.

2 PY. Ndërkohë që paraqitet ky dokument, z. Zyrapi, a keni
3 dëgjuar për Milaim Zekën, një gazetar i njohur në Kosovë?
4 PË. Po.

5 PY. Z. Zyrapi, ky është një artikull i shkruar nga Milaim
6 Zeka që mban datën 3 gusht 2015. I botuar, është, pra,
7 artikull i botuar në 2015. A pajtoheni me mua -- së pari, do
8 të doja t'ju kërkoja të lexoni tek rreshti ku thotë:

9 "Kush janë personat që do të akuzohen?

10 "Këta janë katërshja e parë."

11 Personi i parë në këtë listë është:

12 "Bislime Zyrapi, ish shefi i Shtabit të Përgjithshëm të
13 UÇK-së."

14 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është kjo
15 diçka që e kanë ngritur Gjykatësit në pyetjet e veta? Sepse
16 këto janë pyetje që duhet të bëhen si pasojë e pyetjeve të
17 bëra nga Gjykatësit.

18 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Unë
19 parashtroj, të nderuar Gjykatës, por ndoshta do të ishte mirë
20 që ta jepja qëndrimin tim pa praninë e dëshmitarit.

21 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

22 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Për herë të parë në përgjigje
23 të pyetjeve të Gjykatësve, ky dëshmitar ka pretenduar fakte të
24 reja, apo ka dhënë fakte të reja kundër z. Krasniqi. Këto
25 deklarata ose këto fakte nuk i ka dhënë asnjëherë përpara

1 TPNJ-së apo përpara asnjë instance tjetër.

2 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë po flas
3 për këtë rast. Çfarë lidhje kanë këto pyetje me lidhjet e bëra
4 prej Trupit Gjykues.

5 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Është qëndrimi ynë, të nderuar
6 Gjykatës, që dëshmia e këtij dëshmitari ka zhvilluar, është
7 ndryshuar. Dhe kur Gjykatësit i kanë pyetje, ai është ndjerë
8 që të ndihet i detyruar që t'i japë përgjigje që kanë dashur
9 të dëgjojnë Gjykatësit. Ky është qëndrimi ynë. Unë kam
10 detyrën, të pakën detyrën etike, që ta lejoj atë që t'i
11 përgjigjet pyetjeve.

12 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Hiqeni atë
13 dokument nga ekрани sepse ky dokument nuk ka fare lidhje me
14 pyetjet e Gjykatësve. Ju lutem vazhdoni me pyetjet e tjera.

15 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]
16 PY. Z. Zyrapi, qëndrimi im është që ju e keni ndryshuar
17 dëshminë tuaj në disa fusha. Tani thoni që Jakup Krasniqi ka
18 mbikëqyrur sektorin ligjor, një sugjerim që Sokol Dobruna i ka
19 raportuar Jakup Krasniqit, drejtoria informative i ka
20 raportuar Jakup Krasniqit, dhe sikurse e thashë dhe më herët
21 që Jakup Krasniqi ka pasur kompetencën për të urdhëruar
22 arrestimet - unë po ju them që ju e keni zmadhuar, ekzagjeruar
23 qëllimisht rolin dhe kompetencat e Jakup Krasniqit. A
24 pajtoheni me këtë qëndrim timin?

25 PË. S'pajtohena aspak hiç, se aspak s'e kam ekzagjeru rolin e

1 Jakup Krasniqit. E kam spjegu ato simbas pyetjeve që është bo,
2 simbas përgjegjësive dhe ushtarake që janë kon dhe kanë pasë
3 në atë kohë.

4 PY. Më duhet t'ju pyes, a ka ushtruar ndokush ndikim mbi ju
5 për të hedhur fajin mbi Jakup Krasniqin në çështjet e ngritura
6 dhe për ta bërë përgjegjës Jakup Krasniqin sa i takon pyetjeve
7 të bëra, pavarësisht nga fakti që ju e dini që ai nuk e ka
8 bërë këtë gjë?

9 PY. Pikësëpari, kurrfarë presioni s'kam pas nga askush. Mua
10 [E pakuptueshme] veç sistemi siç ka vepru edhe qysh ka qenë në
11 atë kohë. Unë e kam spjegu se cilat janë përgjegjësitet, e kush
12 çfarë përgjegjësie ka pas, edhe tani po e spjegoj të njëjtën
13 se kush, cilat përgjegjësi janë kon. Edhe unë kurrfarë
14 ndryshimi të deklaratave nuk kam bo prej deklaratave që kam
15 dhënë para gjykatave, me pjesë që kam dhënë, me betimin që të
16 jap të drejtën, vetëm të vërtetën, të tregoj ato ç'ka di dhe
17 ç'ka ka qenë e imja që unë di edhe kam pa, edhe kam mund të
18 has.

19 Asgjë diçka tjetër veçantë. Në qoftë se pretendoni për
20 ato që thirrjet e tona që kanë qenë si dëshmitarë të dyshuar,
21 të gjithë ç'ka jemi thirrur në 2019, pa marrë parasysh unë,
22 dhe krejt edhe këta që janë këtu, edhe ata që kanë qenë, janë
23 të njëjtat thirrja, dëshmitar i dyshuar. Kështu që mos u lidh
24 në atë drejtim se vetë për shkak të kësaj nuk jam që kam
25 folur, ose jam tuj fol. Vetëm kam fol realitetin e një sistemi

1 që ka qenë në atë kohë. Asgjë më tepër.

2 PY. Z. Zyrapi, ju jeni këtu si i dyshuar, jeni këtu së bashku
3 me avokatin tuaj dhe po ju them që dëshmia që keni dhënë këtu
4 është e rreme dhe dëshminë e keni dhënë për të mbrojtur
5 lëkurën tuaj.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] U bë kjo pyetje, mori përgjigjen.

7 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

8 Z. Zyrapi, përfunduar me dëshminë tuaj. E vlerësojmë që
9 keni qenë me ne, që keni qenë i duruar dhe keni bërë më të
10 mirën e mundshme për t'ju përgjigjur pyetjeve. Ju urojmë
11 gjithë të mirat dhe tani mund të largoheni nga salla e gjyqit.
12 Edhe një herë ju falënderojmë për praninë tuaj këtu.

13 Z. Avokat, ju falënderojmë edhe juve që ishit i pranishëm
14 dhe që e ndihmuat z. Zyrapi.

15 Z. VANREUSEL: [Përkthim] Faleminderit. Ka qenë nder për
16 mua që të jem i pranishëm këtu.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
19 nuk ka ndonjë gjë tjetër? Nuk duket se ka ndonjë gjë. Apo, po.

20 Z. Emerson.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se pyetët në
22 qoftë se ne kemi ndonjë çështje tjetër për të ngritur? Në këtë
23 rast më duhet të them që, po, unë shkurtimisht kam diçka për
24 të shtuar.

25 Vërejtja që ZPS-ja ka -- me shkrim sot në mëngjes ka

1 kërkuar rishikimin e përkthimit të një dokumenti me ERN që ka
2 të bëjë me "Rregullore Provizore të Shtabit të Përgjithshëm të
3 Njësisë Informative të Drejtorisë së Informative". Domethënë,
4 është një dokument të cilin unë e kam paraqitur që nuk kishte
5 lidhje në fakt me pyetjet e Gjykatësve, por ne kemi një
6 përkthim të EULEX-it që tregon që në fakt ka qenë keqpërkthim
7 të dokumentit të përdorur nga Prokuroria, dhe për këtë arsye
8 dua që të kërkoj që të ndryshohet titulli i rregullores në
9 mënyrë të tillë që të reflektojë në origjinal, pra, versionin
10 origjinal, sepse sikurse e thashë, dokumenti i TPNJ-së ka një
11 tjetër titull dhe domethënë nuk ka këtë fjalën "informative",
12 por ka një fjalë tjetër. Pra, për këtë arsye do kërkoja që të
13 bëhet korrigjimi i përkthimit dhe i versionit përkatëse në
14 listën e dokumenteve.

15 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. E
16 bëtë të qartë për procesverbal.

17 Nuk e di në qoftë se keni ndonjë tjetër për të shtuar.

18 Në qoftë se jo, atëherë do e mbyllim këtu dhe do të
19 takohemi kur t'i vijë radha herës tjetër.

20 --- Seanca mbyllet në orën 10.23

21

22

23

24

25